

EUROPA E SHEKULLIT XIX DHE LETËRSIA E RILINDJES KOMBËTARE

Teuta ARIFI¹

1 Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology "Blazhe Koneski", University "Ss. Cyril and Methodius" -
Skopje*

Corresponding author e-mail: teutarifi@gmail.com

Përmbledhje

Ky punim ka për qëllim të shtruarit e disa pikëpamjeve sa i përket kontekstualizimit të letërsisë dhe mendimit intelektual shqiptar të shekullit XIX brenda ideve europiane të asaj kohe. Tezë kryesore e punimit është: *Europa e shekullit XIX dallon nga kuptimi i sotëm për Europën si një entitet kulturor dhe politik i bashkuar dhe nisur nga ky aspekt letërsia dhe mendimi intelektual shqiptar është në vijë me idetë e iluminizmit francez, ndërkohë që ndërtimi identitar i çështjes shqiptare ka një paralelizëm me ndërtimin identitar gjermanofon.* Duke u nisur nga fakti që shekulli XIX është shekulli i ndërtimit të identiteteve etnike ashtu siç i njohim sot, si dhe duke pasur parasysh faktin që këto identitete etnike në Ballkan ndërtohen me udhëzim dhe ndihmesë të fuqive ndërkombëtare konkurruese njëra me tjetrën, atëherë edhe identitetet e reja etnike janë në konkurrencë dhe garë mes tyre për njohje dhe etablim në skenën ndërkombëtare të mendimit, politikës, letërsisë dhe gjuhësisë, dhe ajo skenë ndërkombëtare në shekullin e XIX është kontinenti Europian.

Në këtë kuptim, letërsia e Rilindjes Kombëtare është letërsi e angazhuar, letërsi me mision identitar e cila i vë vehtes detyrën pedagogjike, linguistike dhe mbi të gjitha misionin e bërjes së njohur të identitetit dhe kulturës shqiptare në botën e dijes dhe shkrimit europian të kohës. Teoritë mbi të cilat bazojnë këtë punim janë teoritë moderne dhe postmoderne mbi identitetin siç janë mendimet e Balibar, Walestaj, dhe Moren, teori sipas të cilave ndërtimi identitar ka për bazë një kulturë, një gjuhë dhe një territor të caktuar i cili në kushte të veçanta arrin të identifikohet si entitet më vehte dhe i cili krijon në këto baza idetë e shtetformësisë së vet. Sipas kësaj mendimi intelektual i Rilindjes Kombëtare i vë vehtes si detyrë kryesore ndërtimin dhe mbi të gjitha promovimin intelektual të këtij identiteti në qendrat e vendosjes europiane gjë që shpjegon edhe botimet në qendrat europiane të veprave mbi identitetin shqiptar të autorëve: Pashko Vasa, Naim Frashëri, Elena Gjika dhe Sami Frashëri.

Linja e përbashkët ideore e të gjithë autorëve të Rilindjes Kombëtare Shqiptare është ajo që me fjalorin e sotëm do ta emërtonim si pan-europianizëm ndërkohë që në shekullin XIX do të shihej si orientim oksidental sa i përket vlerave kulturore dhe përkatësisë identitare. Letërsia e kësaj kohe është në funksion të ndërtimit të një identiteti shqiptar-europian të kundërt nga identiteti oriental nga i cili dëshron të ndërtojë distancë, është në funksion të argumentimit të trashëgimisë antike jo vetëm si traditë shekullore, por si e drejtë për të pasur vend dhe shtet në Ballkan, është në funksion të ndërtimit të supra-identitetit etnik të cilit i nënshtrohen format e tjera të identitetit kolektiv. Si përfundim, letërsia e Rilindjes Kombëtare, jo vetëm që vendos krijimet e veta në kontekst europian, por duke vendosur kuptimin europian në themelet e ndërtimit identitar shqiptar i jep këtij identiteti vendin e vet në kulturën e sotme europiane.

Fjalë kyçe: identiteti, Europa, Rilindja Kombëtare, oksidenti, orienti.

Europa, ky ideal i përhershëm

A është Europa një ideal, një dëshirë, një ëndërr apo një realitet objektiv? Është një kontinent, apo më shumë se një kontinent? Është koncept letrar, lingvistik, filosofik e politik, apo të gjitha këto së bashku? Këto pyetje të cilat mund të vazhdojnë deri në pafundësi dëshmojnë karakterin shumëdimensional të konceptit Europë, koncepti i cili mitologjikisht është dëshmi për të humburën në kërkimin e së cilës shpenzohen jetët njerëzore për mijëra vite, kurse në kuptimin e realitetit të sotëm është një garë e shteteve për të aderuar në bashkimin e shteteve të emërtuar si Bashkim European. Letërsia si një shprehje me ndjenja e realiteteve të caktuara objektive, mbetet në këtë ndër-hapsirë si gjeografi dhe në këtë ndër-kohë si histori dhe në këtë ndër-situatë të zhvillimit dhe ndryshimeve të kohës dhe rrethanave në kontinentin europian.

Duke qenë një koncept mendtor, filosofik, civilizues dhe shoqëror, Europa është koncept në transformim të përhershëm, ndryshim në ide dhe ndryshim në zhvillim dhe këto ndryshime përbëjnë inspirimin e zhvillimit të shoqërisë Perëndimore që nga feudalizmi inkuizicional e gjer tek idetë liberale të ditëve të sotme. Gjatë këtij procesi transformues të gjashtë shekujve të fundit, shekulli i XIX-të veçohet si për nga idetë filosofike dhe shoqërore, po ashtu edhe për nga ndryshimet e mëdha politike rezultat i së cilave është gjeografia e re politike europiane e cila me pak ndryshime është edhe gjeografia politike e Europës së sotme.

Konteksti europian i shekullit XIX

Shekulli XIX-të në Europë dallon përka shumësi e konteksteve që duhen identifikuar dhe analizuar për të vendosur pastaj zhvillimet ballkanike brenda këtyre konteksteve si zhvillime të përgjithëshme dhe në mesin e këtyre zhvillimeve të vendosim ndryshimet në procesin e krijimit të identitetit shqiptar gjatë shekullit XIX dhe konform kësaj edhe orientimin e letërsisë shqiptare të kësaj kohe. Europa e shekullit XIX-të është Europa post-revolucionare, është kjo periudha kur ka përfunduar Revolucioni Demokratik Borgjez Francez, bile ka kaluar edhe koha kur ky Revolucion kishte gëlltitur edhe vetë *fëmijët* e vet. Duke dashur të kufizonin përhapjen më të gjerë të ideve anti-monarkiste dhe revolucionare Britania e Madhe, Austria dhe Rusia do të formojnë *Koncertin e Europës* në Vienë në vitin 1814, si një formë organizimi politik dhe ideologjik të shteteve fitimtare nga luftërat napoloniane.

Ide kryesore e këtij bashkëpunimi është mbajtja e paqes në Europë si dhe mbajtja e monarkive si sisteme të sfiduara nga idetë dhe lëvizjet revolucionare. Skena europiane e kësaj kohe nënkupton një Francë post-napoloniane të mundur dhe të kthyer në kufinj të saj të sotëm, një Britani ishullore e cila është jo edhe aq e interesuar për të ndërhyrë në zhvillimet kontinentale, një Gjermani e ndarë në më shumë principata me qendër Prusinë e fuqishme ushtarakisht, një Itali e ciptuar mes Austro-Hungarisë dhe Burbonëve, një perandori Austro-Hungareze si fuqi kryesore gjermanofone, një Rusi cariste tejet e interesuar për zhvillimet në Europë dhe një perandori Otomane në rrënim e sipër në Jug-Lindjen europiane.

Kjo periudhë historike mundëson krijimin e dy identiteteve të përgjithëshme në truallin europian, identitete rreth të cilave do të zhvillohet koncepti i mëvonshëm i shteteve dhe rregullimeve shtetërore dhe shoqërore në Europë: identitetet e kombeve-shtete dhe konceptet ideologjike rreth rregullimit të brendshëm shoqëror, pra republika apo monarkia. Të gjitha këto zhvillime intensive të cilat kanë për rezultat ndryshimin rrënjësor dhe konceptual të Europës definojnë si *shekulli i gjatë i XIX*³⁹², i cili sipas Midwell-it zgjat nga 1789 e cila është data e Revolucionit Francez e gjer më vitin 1945 kur mbyllet sipari i luftërave në tokën europiane, mundet ushtarakisht ideologjia nazi-fashiste dhe fillon të menduarit e ri për Europën si një bashkësi vlerash shoqërore dhe njerëzore.

³⁹² Hudson Meadwell *The Long Nineteenth Century in Europe*, Review of International studies, N.27, p. 165-189, British International Studies Association, London, 2001;

Sipas kësaj, shekulli XIX nuk është vetëm koha e përcaktuar teknikisht dhe me kalendar e një njëqindveçari, por në pyetje janë procese të cilat përkah natyra dhe dinamika që kanë shënojnë ato ndryshime që identifikojnë një shekull i cili shtrihet brenda dy shekujve kalendarikë. Sipas vlerësimit tim, shekulli XIX-të zgjatet edhe përtej vitit 1945 dhe përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe arrin deri tek vitet 90-të kur edhe rrënohet sistemi komunist si diktatura e fundit në truallin evropian dhe kjo rënie riaktualizon çështjet e pazgjidhura etnike në Ballkan, për të rikthyer në studimet teorike historinë e ndërtimit identitar në fillet e shekullit XIX.

Pra, në kontekstin e zhvillimeve politike dhe shtetërore kontinenti evropian i shekullit XIX-të territorialisht dhe në kuptimin zhvillimor ndahet në dy pjesë: *qendra europiane* si pjesa në të cilën zhvillohen idetë dhe në mënyrë dinamike dhe të pavarur ndodhin ndryshimet politike, ideore dhe shoqërore nga njëra anë dhe *periferia europiane*, e cila nënkupton Europën Qendrore dhe atë Juglindore, si identitete në formim dhe si periferi kulturore europiane. Ky relacion mes *qendrës* dhe *periferisë* kulturore determinon këto marrëdhënie tanimë shekullore brenda vetë kontinentit evropian. *Qendra europiane* dallohet me sfidën e re të cilën në skenë e sjell Revolucioni Francez, dhe kjo sfidë e re është republikanizmi si ide dhe si praktikë e re e pushtetit dhe rregullimit shtetëror.

Skena europiane e kësaj kohe është në betejën ideore mes konceptit të republikanizmit dhe monarkisë, betejë kjo e cila në kontekstin kohor shtrihet deri në vitin 1945, kur edhe përfundimisht republikanizmi arrin të krijojë hapsirën reale të ekzistimit praktik. Republikanizmi radikal i cili pritet me ngurim në Europën e monarkive më të mëdha apo më të vogla është katalizatori i cili detyron monarkitë europiane të tërhiqen nga pushteti i fuqishëm i monarkisë në llogari të parlamenteve demokratike, për të arritur në idealet e zhvillimit të demokracisë e cila nuk do të vihet në rrezik as nga radikalizmi republikan e as nga monarkizmi absolut.

Ky koncept demokratik përbën edhe bazën e atyre vlerave të cilat sot identifikohen si vlera euro-atlantike. Në kuptimin e gjeografisë politike dhe shtetërore të Europës së shekullit XIX-të, bashkimi i principatave dhe formimi i shtetit të bashkuar gjerman është determinuesi i zhvillimeve deri në vitin 1945, dhe ky proces identitar dhe politik pashmanshmërisht ka ndikimin e vet të madh edhe tek pjesa të cilën e quajmë *periferi europiane*.

Shteti komb – përcaktuesi kryesor identitar i Europës së shekullit XIX-të

Nëse në definimin e Europës dhe europianes udhëhiqemi nga koncepti i shkëlqyeshëm dhe inovativ i Edgar Morenit, atëherë gjithësesi se qëndrimi që *Europa u bë nocion gjeografik vetëm sepse u bë nocion historik*,³⁹³ përbën shpjegimin e faktit që identiteti evropian është i tillë falë metamorfozave të pësura gjatë historisë. Një identitet i cili është antik fillimisht, krishter në Mesjetë, i përballur me Islamin si një religjion dhe kulturë dhe në bashkëjetesë me këtë vlerë, një identitet principatash në fillim dhe identitet shtetesh më vonë, thjesht një poli-identitet i cili nuk mund të quhet si një dhe i vetëm.

Duke pasur formën e një ekosistemi me shumë nënsisteme, me shumë koka në fakt kështu kuptojmë atë divergjencë dhe ndryshim të Europës së sotme. Europa e shekullit të XIX-të është Europa e shteteve dhe ky transformim jo vetëm shoqëror e shtetëror, por edhe njerëzor shënon dinamikën e zhvillimit dhe transformimit evropian. Shteti, kjo bashkësi e cila i jep individit ndjenjën e një të kaluarë të fuqishme dhe të lashtë, sepse e kaluara është mbi të gjitha fenomen politik³⁹⁴ dhe realitetin e një mbrojtjeje dhe realizimi individual është simbolikisht figura e fuqishme e babait dhe kraharori i i ngrohtë i nënës, është vendi, toka e përcaktuar me kufinj,

³⁹³ Edgar Moren, *Europa në Mendje*, Libra për një shoqëri të hapur, Shtëpia e Librit, Tiranë 2001;

³⁹⁴ Etienne Balibar & Immanuel Wallerstein, *Race, Nation, Class, Ambiguous Identities*, Verso, London-New York, 2000;

dheu, vendi, atdheu/mëmëdheu. Dhe letërsia shqiptare e shekullit XIX-të ka këtë përcaktim identitar të definimit të vendit/atdheut.

Në letërsinë dhe veprimtarinë e Rilindjes Kombëtare shteti është një ideal, dhe më shumë se një ideal, është vizion për një shtet në ndërtim i projektuar në veprat ideore dhe politike të kësaj periudhe.³⁹⁵ Në kuptimin praktik shtetformimi përbën zhvillimin kryesor shoqëror, politik dhe strukturor të Europës së shekullit XIX-të dhe Ballkani së bashku me shqiptarët janë pjesë e pandarë e këtij procesi. Duke qenë në një vorbull intensive ngjarjesh dhe të gjendur mes dy Perandorive, identiteti shqiptar në kuptimin e ndërtimit politik përcaktohet në kuptimin civilizues në ndarjen esenciale mes Lindjes dhe Perëndimit.

Duke u nisur nga një organizim esencial politik si që është Lidhja Shqiptare e Prizrenit e cila i vendos e para konturat e idealit të shtetësisë shqiptare, shtetësi kjo e konceptuar si autonomi e gjerë brenda Perandorisë Osmane si partneritet strategjik që do të mundësonte ruajtjen si të paprekur të territorit etnik shqiptar, për tu transformuar më tej si angazhimi për formimin e shtetit shqiptar sipas modelit të shtetit-komb të shekullit XIX-të. Por ky ideal mbetet i cunguar në praktikë si rezultat i rrethanave gjeo-politike të Ballkanit të atëhershëm, dhe si rezultat i hegjemonisë agresive të shteteve të sapoformuara ballkanike në fqinjësi të shqiptarëve, që ndërtonin shtetet e reja jo vetëm bazuar në konceptin shtet-komb, por të bazuara në konceptin e pastrimit etnik dhe eliminimit të *tjetrit* si gjuhë, kulturë apo identitet, gjë që peshon akoma mbi proceset e papërfunduara gjeo-politike të Ballkanit të sotëm.

E gjendur në këtë situatë të re gjeo-strategjike, pa aleanca natyrore të tjera dhe me një bashkëjetesë shekullore brenda sistemit politik otoman, lëvizja e organizuar politike shqiptare kërkon aleanca të reja të cilat do ta vendosin në rrafsh të barabartë me fqinjët në konkurrencën territoriale për të ndërtuar shtetin-komb, proces ky jo vetëm kompleks, por gatisë dhe i pamundur pa të paktën një aleancë Perëndimore. Dhe kjo aleancë e re e diktuar nga rrethanat në Europë dhe Ballkan në atmosferën e tensionuar të Krizës Lindore, poashtu e diktuar nga interesat reale politike dhe strategjike të shteteve gjermanofone është vendosja e komunikimit politik dhe bashkëpunimit me Austro-Hungarinë si përfaqësuesi kryesor i politikave gjermanofone në Ballkan.

Perandoria Austro-Hungareze tanimë kishte një prani tradicionale brenda botës shqiptare, edhe atë në Shkodër si qendër katolike, duke pasur parasysh faktin që Austro-Hungaria kishte statusin e përkujdesësit të bashkësisë krishtere-katolike brenda Perandorisë Osmane, status ky i garantuar me marrëveshje dypalëshe, mes dy perandorive. Pas kërkesës së Ferit Bej Vlorës drejtuar në formë memorandumit Ministrisë së Jashtme perandorake në Vienë dhe diskutimit të këtij Memorandumit në Ballhausplatz, autoritetet austro-hungareze vendosin për ngritje të nivelit të angazhimit lidhur me çështjen shqiptare, duke konsideruar këtë Memorandum si një kërkesë e cila tejkalon interesimin religjioz-katolik për shqiptarët, për ta transformuar këtë interesim në një interes politik dhe strategjik. Si rezultat i kësaj kthese vjen dhe interesimi e paskëtaj dhe botimet e shumta të studiusve gjermanofonë mbi gjuhën dhe kulturën shqiptare,³⁹⁶ mbi letërsinë popullore dhe etnokulturën shqiptare në përgjithësi që ka për rezultat njohjen europiane për shqiptarët dhe kulturën e tyre.

Shumësia identitare europiane e shekullit XIX dhe letrat shqipe

Letërsia shqiptare e shekullit XIX-të dallohet me shumëdimensionalitetin e saj, një letërsi e shumë gjinive, lirikës, dramës, romanit të parë me tematikë shqiptare, veprave të natyrës edukativo-shkollore, përmbledhjeve të poezisë popullore, dhe me të gjitha këto forma dhe shumënduarësi sikur të kujton periudhën e renesansës italiane të atij çlirimi masovik mendor

³⁹⁵ Pashko Vasa, *E vërteta për Shqipërinë dhe Shqiptarët*, Rilindja, Prishtinë, 1989;

³⁹⁶ Teuta Arifi, *Konteksti gjeopolitik, letrar dhe filozofik i studimit shkencor gjerman mbi letërsinë dhe gjuhën shqipe*, Ditët e Alfabetit 4, ITSHK, Shkup, 2023;

dhe shpirtëror, për përshkrimin e të cilës nuk mjaftonin letrat për ta shprehur. Kjo letërsi shqiptare është letërsi e vetnjohjes, letërsi e rilindjes së të kaluarës antike dhe mesjetare iliro-arbërore, letërsi e cila mëton të çlirojë, të njohë, të edukojë dhe të ndryshojë. Dhe mbi të gjitha kjo letërsi kontekstualizon vehten si europiane në kuptimin kulturor dhe të vlerave.

Me rëndësi të posaçme është të nënvizojmë faktin që deri në vitin 1800 nuk kemi terminin apo kuptimin e *europianizimit*, dhe ky koncepti i të qenit kulturë e zhvilluar filosofike dhe shoqërore me rolin e epiqendrës civilizuese bëhet inspirim i jo vetëm letërsive, por njëkohësisht edhe lëvizjeve të organizuara politike dhe kombëtare të kombeve të Ballkanit dhe Europës Lindore. Ky kuptim i europianizimit do të zhvillohet në dy krahë:

1. Krahu inspirativ – pra identifikimi i një kombi si pjesëtar dhe kontribues në kulturën dhe civilizimin europian, dhe

2. Krahu kolonizues, i cili ndërtoi konceptet e kulturës koloniale, pra atë të *civilizimit* të popujve të primitivë, barbarë dhe të pacivilizuar.

Veprat e Rilindjes sonë kombëtare vendosin identitetin shqiptar si pjesë të pandashme të identitetit europian, por njëkohësisht këtë identitet e shohin si pjesë për të cilën nevojitet luftë dhe angazhim aktiv, për të mos u bërë kombe të kolonizuar: *O vëllezër Shqipëtarë! Të mos na gjejë si ata të Australisë e Afrikësë, që ven evropjanët e i gënjejnë me ca ruaza e me ca drangole të qelqëta e pasqyra të pafillta e u marrin vendet e tyre nga dora.*³⁹⁷ Identiteti europian i Rilindjes Kombëtare nënkupton Europën e barazisë, lirisë, solidaritetit dhe kursesi një Europë koloniale.

Po qe se nisemi nga kuptimi dhe definimi i Europës si si një *Europë Policentriste*³⁹⁸, atëherë janë dy aspekte të njohjes dhe kulturës së dijes europiane atë të cilat duhen vënë në një rrafsh krahasues me letrat dhe idetë e Rilindjes sonë kombëtare: romantizmi gjerman dhe iluminizmi francez. Sa i përket romantizmit gjerman, letrat e Rilindjes Kombëtare nuk kanë kontaktin direkt me letërsinë dhe veprimtarinë më të gjerë të romantizmit gjerman, duke qenë se shkrimet shqipe të shekullit XIX-të janë të shumtën e rasteve në dy gjuhë edhe atë në gjuhën italiane kur është fjala për autorët arbëreshë, turke kur është fjala për autorët e Shoqërisë së Stambollit, në gjuhët greke dhe persiane kur flasim për Naim Frashërin si dhe në gjuhën franceze si gjuhë diplomatike e shekullit XIX-të.

Ndikimi dhe bashkëpunimi real me kulturën gjermanofone do të vijë si rezultat i riorganizimit gjeostrategjik në relacionet dhe politikat e Austro-Hungarisë në Ballkan që do të ketë si përfundim studimet gjermanofone mbi shqipen dhe shqiptarët nga njëra anë, dhe njohjen dhe ndikimin e shkrimeve gjermane në letrat shqipe në anë tjetër që shprehet në dekadën e fundit të shekullit XIX-të dhe fillimet e shekullit XX. Megjithatë ajo e cila e përbashkon romantizmin gjerman me romantizmin e popujve të Europës Juglindore, përfshirë këtu edhe shqiptarët, është karakteristika e përbashkët e një letërsie e cila është shoqëruese e pandarë e procesit të formimit të identitetit kolektiv kombëtar si proces paralel me proceset e shtetformimit si proceset më dinamike në truallin europian gjatë dy shekujve të fundit.

Romantizmi gjerman i i nisur me vrullin e lëvizjes *Sturm und Drang* (Stuhi dhe sulm), do të shënojë vrullshëm shekullin e XIX duke e identifikuar romantizmin si një drejtim tipik gjerman³⁹⁹ dhe ngushtë të lidhur me zhvillimet e përgjithëshme që shoqëruan këtë drejtim letrar. Historicizmi, botimi i letërsisë së traditës popullore, rinjohja dhe botimi i eposit gjerman *Nibelungen*, shënojnë bazën mitologjike të ndërtimit të identitetit të kombit-kolektiv i bashkuar tani nën shtetin e ri gjerman të udhëhequr nga Bismarcku. Ky moment i rikthimit në të kaluarën e lavdishme, i bashkëveprimit të mitit dhe historisë, ndërton të drejtën e shtetformimit në shekullin e XIX-të, kur shteti-komb duhet të ketë rrënjët e veta të thella mitologjike dhe historike, për tu krijuar e më vonë për të funksionuar si bashkësi shtetërore.

³⁹⁷ Sami Frashëri, *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet?*, Rilindja, Prishtinë, 1978;

³⁹⁸ Edgar Moren, *Europa në Mendje*, Libra për një shoqëri të hapur, Shtëpia e Librit, Tiranë 2001;

³⁹⁹ P.S. Kohan, *Istoriya Zapadnoevropske Knjizevnosti*, Veselin Maslesa, Sarajevo, 1971;

Konceptualisht kjo edhe përbën vijën e përbashkët ideore mes romantizmit gjerman dhe lëvizjeve kombëtaro-letrare të popujve të cilët duke dalur nga pushteti i Perandorisë Otomane ndërtojnë jo vetëm identitetin e tyre komb-shtetëror, por njëkohësisht kërkojnë rrënjë mitologjike-historike si platformë për të mbajtur këtë identitet. Në këtë kompleksitet rrethanash gjenden edhe shqiptarët të cilët në një afat të shkurtër kohor duhet të definojnë identitetin e tyre evropian dhe lëvizja intelektuale e kësaj kohe dëshmon një vetëdije të veçantë në të kuptuarit të sfidës së madhe të ndërtimit të këtij identiteti kolektiv-kombëtar-shtetëror-evropian.

Nëse në kuptimin e frymës dhe paralelizmit të rrethanave komb-shtet-ndërtuese Rilindja jonë është e njëkohëshme me romantizmin gjerman, në kuptimin e ideve dhe koncepteve që promovon, Rilindja jonë është e një vije ideore me iluminizmin francez dhe idetë e thella reformuese, ndriçuese dhe racionaliste të këtij mendimi të madh i cili ndryshoi kuptimësinë evropiane sa i përket dijes, njohjes dhe lirive e të drejtave njerëzore. Edhe pse një letërsi dhe lëvizje intelektuale e zhvilluar gjatë periudhës së romantizmit, edhe pse në traditën franceze flitet për një bashkëjetesë substanciale të ideve të iluminizmit dhe romantizmit,⁴⁰⁰ megjithatë Rilindja Kombëtare udhëhiqet dhe shkruan për idetë iluministe dhe atë që kjo Lëvizje e quan dhe identifikon si mendim dhe orientim evropian, është koncepti ideor i iluminizmit francez.

Letërsia e Rilindjes është një letërsi e angazhuar e cila krijon iluminizmin kombëtar⁴⁰¹ për të bërë një ndryshim thelbësor në shoqërinë dhe shpirtin kolektiv të bashkësisë që i drejtohet, ashtu siç edhe iluminizmi francez nënkupton një mendim filosofik të angazhuar për ndryshime shoqërore dhe një shkencë në rritje e angazhuar për përmirësimin e kushteve jetësore të qytetarit evropian. Ai program i iluminizmit për të vendosur diturinë si shpëtim⁴⁰² dhe çlirim të mendjes njerëzore përqafohet fuqishëm nga ideologët e Rilindjes, të vetëdijshëm se shkrimet e tyre nuk i shërbejnë vetëm letërsisë por janë pjesë e të mësuarit apo ndriçuarit, koncepte të përdorura në të njëjtën mënyrë si nga Naimi, ashtu dhe nga Didroi.

Shkenca sipas iluminizmit është jo vetëm ndryshim dhe përparim por edhe afrimi i vërtetë tek besimi në kuptimin teologjik, apo thënë ndryshe me fjalët e Naimit: *si meshatar në tempull është shkenca, që njeriun afron tek perëndia, q'është gjithëçka në botë.*⁴⁰³ Në veprat e tyre, autorët e Rilindjes Kombëtare dëshmojnë që njohin autorët iluministë dhe njëkohësisht inspirohen nga idetë shoqërore iluministe. Këto ide kanë për rezultat Revolucionin Francez i cili është lokal për nga vendngjarja por universal sa u përket implikimeve⁴⁰⁴, dhe si implikim i këtij revolucioni në kuptimin ideor është baza inspirative e revolucionit kombëtar të shekullit XIX-të tek shqiptarët.

Identiteti evropian i Rilindjes Kombëtare

Për të shpjeguar këtë kuptimësi të identitetit evropian të shqiptarëve dhe të koherencës identitare dhe kulturore shqiptaro-evropiane, duhen veçuar veprat programatiko-ideologjike të periudhës së Rilindjes kombëtare me sa vijon: Pashko Vasa, *E vërteta për shqipërinë dhe shqiptarët*, Elena Gjika, *Kombësia shqiptare sipas këngëve popullore*, Sami Frashëri *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë* dhe Naim Frashëri me *Dëshira e vërtetë e shqipëtarë vet*. Shekulli i XIX-të është shekulli i identiteteve të cilat dalin nga vorbullat perandorake dhe bëhen bazamenti i shtetit-komb. Ky është edhe koncepti i veprave të sipërpërmendura të cilat shtetin-komb e territorializojnë dhe i përcaktojnë hapsirën identitare.

⁴⁰⁰ Masar Stavileci *Iluinizmi në Letërsinë e Rilindjes Kombëtare*, Toena, Tiranë, 2000;

⁴⁰¹ Rexhep Qosja *Prej tipologjisë deri te periodizimi*, ASHAK, Prishtinë, 1979;

⁴⁰² Maks Horkheimer & Teodor Adorno, *Dijalektika Prosvjetitelstva*, Logos, Sarajevo, 1980;

⁴⁰³ Naim Frashëri, *Dëshira e Vërtetë e Shqipëtarëve*, Toena, Tiranë, 2000;

⁴⁰⁴ Hudson Meadwell *The Long Nineteenth Century in Europe*, Review of International studies, N.27, p. 165-189, British International Studies Association, London, 2001;

Në këtë kuptim e drejta për shtet del nga trashëgimia antike-europiane, pra duke qenë një prani mijëvjeçare antike del edhe e drejta për të qënë komb-shtet i hartës europiane në formim e sipër. Në këtë proces identitar shqiptarët nuk janë të vetmit që hapërojnë, bashkë me ta janë edhe kombet e tjerë të Ballkanit dhe ky proces do të prodhojë konkurrencën ndërmjet tyre sa i përket trashëgimisë në kuptimin kulturor, dhe luftërat etnike në kuptimin gjeo-strategjik dhe politik. (konkurrenca me grekët si ndarje solidare e të kaluarës së përbashkët dhe konkurrenca me serbët për të luftuar mohimin e origjinës antike shqiptare të promovuar nga institucionet akademike dhe letrare serbe).

Fillimet e këtij debati i cili është dhe sot i pranishëm në Ballkanin me probleme jo tërësisht të përfunduara etnike e shohim që në vitin 1886 kur fuqishëm kundërshtohet imponimi i identitetit fetar si identitet kombëtar me qëllime asimiluese dhe akoma më shumë kundërshtohet identifikimi i orthodoksisë universale me identitetin etnik grek.⁴⁰⁵ Duke qenë se shtetet e krijuara në Ballkan në shekullin XIX-të ishin shtete të cilat identitetin e tyre e ndërtoan me konceptin një shtet-një gjuhë-një religjion(orthodoks), Rilindja kombëtare Shqiptare duhej të ishte inovative dhe kreative për të ndërtoar koncept komb-shtet dhe brenda këtij koncepti të akomodonte shumësinë religjioze të shqiptarëve.

Prandaj i një vlere të veçantë në kuptimin identitar është trajtimi i përkatësisë religjioze në këto trajtesa tejet të rëndësishme intelektuale dhe publicitare. Nëse koncepti identitar i ndërtimit të kombit në shekullin e XIX-të është një komb-një gjuhë-një shtet, ajo që sfidon këtë koncept monolit të komb-ndërtimit është shumësia e religjioneve tek shqiptarët. Në këto trajtesa jo vetëm që vendoset koncepti i subordinimit të përkatësisë religjioze përpara identitetit etnik, por edhe ofrohet modeli praktik, i sekularizmit funksional duke ndarë religjionin nga shteti⁴⁰⁶, gjë që sot përbën parimin kryesor të demokracisë liberale europiane.

Letërsia në veçanti dhe veprimtaria më e gjerë e Rilindjes Kombëtare në përgjithësi në kuptimin ideor bazohen në filozofinë e iluminizmit francez, meqë ai përmban konceptet për të cilat edhe angazhohet kjo gjeneratë: revolucionariteti, inovacioni, racionalizmi dhe de-teologjizimi i shoqërisë në formë sekulare dhe republikanizmi parlamentar si formë e qeverisjes shtetërore. Në kohën e veprimtarisë së Rilindjes sonë Kombëtare, Franca ishte republikë e vetme në truallin europian dhe ky rregullim do të jetë edhe ideal i Rilindjes si një kundërvlerë oksidentale e sulltanatit absolut oriental.

Shënime përmbyllëse

Letërsia e Rilindjes Kombëtare i përmbahet kontekstit europian në kuptimin kulturor të fjalës në kohën kur edhe fillon të sendërtohet koncepti i *europianizimit* si opinion kulturor gjithnjë duke pasur parasysh faktin që Europa e shekullit XIX është shumë diverse dhe divergjente në kuptimin politik dhe shtetëror. Europa e kësaj kohe është duke kaluar në kohën e ndërtimit të hartës europiane të ditëve të sotme dhe ky proces përcillet me ndryshime dhe pasoja të shumta dhe probleme akoma të papërfunduara në Europën Juglindore. Në kuptimin krahasimor dhe ideor, veprimtaria e Rilindjes përkon me idetë e iluminizmit francez të shikuara si ide progresive dhe revolucionare, kurse përkaç narracioni emocional kjo veprimtari përkon me romantizmin gjerman i cili është përcjellës i procesit të formimit të shtetit-komb gjerman.

Këto dy aspekte na japin mundësinë të kuptojmë oksidentalizmin e Rilindjes në një kohë kur Europa ishte ide por ishte larg kuptimit dhe realitetit të sotëm të një Europe të bashkuar institucionalisht dhe politikisht. Në kuptimin e zhvillimeve vlerësoj se jemi duke kaluar dekadën e fundit të shekullit të gjatë XIX përderisa në Ballkan qëndrojnë të papërfunduara proceset e definimit të shteteve me fragjilitet etnik, dhe teoria që shekulli i XIX-të është në vijim e sipër i dedikohet faktit të problemeve dhe çështjeve komplekse etnike të cilat mbase

⁴⁰⁵ Naim Frashëri *Dëshira e Vërtetë e Shqipëtarëve*, Toena, Tiranë, 2000;

⁴⁰⁶ Sami Frashëri *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet?*, Rilindja, Prishtinë, 1978

kanë lindur gjatë shekullit XIX-të, por që duhen trajtuar në dritën e sotme të sistemeve demokratike sado fragjile qofshin këto demokraci. Europa mbatet me formën e një ekosistemi me shumësi llojesh e diversitete dinamike, dhe brenda këtij diversiteti në formim dhe ndryshim e sipër mbeten edhe dinamikat e lëvizjeve intelektuale shqiptare, dhe njëra ndër më lapidaret është pikërisht Rilindja Kombëtare.

Referencat

- [1]. Adorno, Teodor & Horkheimer, Maks, *Dijalektika Prosvjetelstva*, Logos, Sarajevo, 1980;
- [2]. Arifi, Teuta, *Konteksti gjeopolitik, letrar dhe filozofik i studimit shkencor gjerman mbi letërsinë dhe gjuhën shqipe*, Ditët e Alfabetit 4, ITSHK, Shkup, 2023;
- [3]. Balibar, Etienne & Wallerstein, Immanuel, *Race, Nation, Class, Ambiguous Identities*, Verso, London-New York, 2000;
- [4]. Frashëri, Naim, *Dëshira e Vërtetë e Shqipëtarëve*, Toena, Tiranë, 2000;
- [5]. Frashëri, Sami, *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet?*, Rilindja, Prishtinë, 1978;
- [6]. Kohan, P.S, *Istorijska Zapadnoevropske Knjizevnosti*, Veselin Maslesa, Sarajevo, 1971;
- [7]. Meadwell, Hudson, *The Long Nineteenth Century in Europe*, Review of International studies, N.27, p. 165-189, British International Studies Association, London, 2001;
- [8]. Moren, Edgar, *Europa në Mendje*, Libra për një shoqëri të hapur, Shtëpia e Librit, Tiranë 2001;
- [9]. Qosja, Rexhep, *Prej tipologjisë deri te periodizimi*, ASHAK, Prishtinë, 1979;
- [10]. Stavileci, Masar, *Iluminizmi në Letërsinë e Rilindjes Kombëtare*, Toena, Tiranë, 2000;
- [11]. Vasa, Pashko, *E vërteta për Shqipërinë dhe Shqiptarët*, Rilindja, Prishtinë, 1989;